



MICHAEL ENDE

MOMOJA

OSE

*Historia e çuditshme e hajdutëve të kohës
dhe e fëmijës që u ktheu njerëzve kohën e vjedhur*

Roman - Përrallë

Përktheu: Sokol Mici




Titulli i origjinalit: *MOMO, Michael Ende*

Copyright © 1973, 2005 by Thienemann Verlag (Thienemann Verlag GmbH),
Stuttgart/Wien

traduki 

Copyright © of the translation: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI
Copyright © i përkthimit: S. Fischer Fondation, me kërkesë të TRADUKI

Botimi i kësaj vepre u mbështet nga TRADUKI, një rrjet letrar, të cilit i përkasin Ministria Federale për Çështje europiane e ndërkombëtare e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale Gjermane, Fondacioni kulturor zviceran Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Instituti Goethe, Agjencia sllovene e Librit JAK, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës së Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit dhe Fondacioni S. Fischer.

Redaktorë: Arlinda Hovi Dudaj
Sejdin Cekani
Kopertina: Studio grafike 
Designer: Vlash Papa
Përpunimi grafik: Greta Konomi



ISBN 978-99943-0-329-8
Shtypur në Shtypshkronjën "Guttenberg"
Tiranë, 2013

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 41 pranë Universitetit
"Marin Barleti", godina nr. 4, Tiranë.
Tel. - fax.: 00355 4 249 944
E-mail: info@botimedudaj.com
Website: www.botimedudaj.com

PËRMBAJTJA

Pjesa e parë: MOMOJA DHE MIQTË E SAJ

Kapitulli i parë

Një qytet i madh dhe një vajzë e vogël..... 13

Kapitulli i dytë

Një veti e pazakontë dhe një zënkë fare e zakonshme..... 21

Kapitulli i tretë

Një kinse stuhi dhe një shtrëngatë e vërtetë..... 30

Kapitulli i katërt

Një plak i heshtur dhe një djalë gojëbrisk..... 42

Kapitulli i pestë

Histori për shumë dhe histori për një..... 51

Pjesa e dytë: ZOTËRINJTË GRI

Kapitulli i gjashtë

Llogaria është e gabuar, po megjithatë del..... 65

Kapitulli i shtatë

Momoja kërkon miqtë e saj
dhe i vjen për vizitë një armik..... 81

Kapitulli i tetë
Një mori ëndrrash dhe ca dyshime 107

Kapitulli i nëntë
Një kuvend i mirë që nuk u mbajt
dhe një kuvend i keq që u mbajt 119

Kapitulli i dhjetë
Një ndjekje e egër dhe një arrati e qetë 129

Kapitulli i njëmbëdhjetë
Kur ligësia bën më të mirën nga e keqja 143

Kapitulli i dymbëdhjetë
Momoja shkon atje prej nga ku vjen koha 152

Pjesa e tretë: LULET - ORË

Kapitulli i trembëdhjetë
Atje një ditë dhe këtu një vit..... 177

Kapitulli i katërbëdhjetë
Të ngrënë me shumicë dhe përgjigje me pakicë 199

Kapitulli i pesëmbëdhjetë
Gjetur dhe humbur 208

Kapitulli i gjashtëmbëdhjetë
Ankth me tepricë 218

<i>Kapitulli i shtatëmbëdhjetë</i>	
Frikë e madhe, guxim edhe më i madh.....	227
<i>Kapitulli i tetëmbëdhjetë</i>	
Kur parashikon pa parë mbrapa.....	237
<i>Kapitulli i nëntëmbëdhjetë</i>	
Të rrethuarit duhet të vendosin	244
<i>Kapitulli i njëzetë</i>	
Ndjeka e përndjekësve	256
<i>Kapitulli i njëzetënjëtë</i>	
Fundi me të cilin fillon diçka e re	265
Një pashënie e shkurtër nga shkrimtari	279

Në errësirë drita jote shkëlqen.
Kushedi nga vjen.
Dukesh kaq afër e po ashtu kaq larg.
Kushedi si të thonë.
Nuk më bëhet vonë:
Vezullo, o yll i vogël, vetëm vezullo!

(Sipas një kënge të vjetër irlandeze për fëmijë)

PJESA E PARË:
MOMOJA DHE MIQTË E SAJ



KAPITULLI I PARË

Një qytet i madh dhe një vajzë e vogël

Në kohërat e lashta, po të lashta ama, kur njerëzit flisnin ende gjuhë të tjera, që atëherë pra, në vendet e ngrohta kishte qytete të mëdha dhe madhështore. Në këto qytete ngriheshin pallatet e mbretërve dhe perandorëve, kishte rrugë të gjera, rrugica të ngushta dhe udhëza të spërdredhura, tempuj të mrekullueshëm me statuja të arta dhe prej mermeri të perëndive, po kishte tregje të larmishme, ku tregtoheshin mallra nga të gjitha vendet e botës, sheshe të bukur e të mëdhenj, ku njerëzit mbledheshin për të folur për të rejtat, për të mbajtur apo për të dëgjuar ligjërata. Por, mbi të gjitha, atje kishte teatro të mëdha.

Ato kishin pamjen që kanë cirqet sot, vetëm se ishin ndërtuar krejtësisht me blloqe guri. Radhët e vendeve ku uleshin spektatorët ishin vendosur shkallë-shkallë mbi njëra-tjetrën dhe formonin një si hinkë të stërmadhe. Kur i shihje nga lart, disa prej këtyre ndërtimeve kishin formë të rrumbullakët rrethore, disa ishin më tepër ovale, kurse disa të tjera kishin formën e një gjysmërrethi të madh. Këto quheshin amfiteatro.

Kishte të tillë të mëdhenj sa një stadium futbollit, por kishte edhe më të vegjël, që nxinin vetëm disa qindra spektatorë. Kishte amfiteatro madhështorë të zbukuruar me kolona dhe figura, por edhe të tillë që ishin fare të thjeshtë e pa zbukurime. Amfiteatrot nuk ishin të mbu-

luar me çati. Çdo gjë zhvillohej jashtë, nën qiellin e hapur. Ndaj dhe sipër radhëve të vendeve të teatrove madhështore tendoseshin sixhade të thurura me ar për të mbrojtur publikun nga dielli përvëlues apo nga ndonjë shi i beftë. Kurse në teatrot e thjeshta, për këtë qëllim përdorëshin hasra xunkthi dhe kashte. Me një fjalë, teatrot ishin sipas mundësive të njerëzve. Po të gjithë donin të kishin një të tyrin, sepse ishin dëgjues dhe spektatorë të pasionuar.

Kur ndiqnin me vëmendje ngjarjet prekëse apo edhe komike që luheshin në skenë, iu dukej sikur jeta e inskenuar atje në mënyre misterioze ishte më e vërtetë se jeta e tyre e përditshme. Ndaj vdisnin t'ia vinin veshin këtij realitetit tjetër.

Mijëra vjet kanë kaluar nga ajo kohë. Qytetet e mëdha të atëhershme janë shkatërruar, tempujt dhe pallatet janë shembur. Era dhe shiu, i ftohti dhe i nxehti i kanë ngrënë dhe zgavruar gurët. Madje edhe nga teatrot e mëdhenj sot kanë mbetur vetëm gërmadha. Nëpër muret e plasaritura vetëm gjinkallat ia marrin këngës së tyre monotone, që tingëllon sikur toka po merr frymë duke fjetur.

Po disa prej këtyre qyteteve të vjetra e të mëdha vazhdojnë të jenë qytete të mëdha edhe në ditët tona. Sigurisht që jeta e tyre ka ndryshuar. Tani njerëzit lëvizin me makina dhe tramvaje, kanë telefona dhe dritë elektrike. Por, aty- këtu, mes godinave të reja ngrihen ende disa kolona, ndonjë portë, ndonjë fragment muri apo edhe ndonjë amfiteatër nga kohët e lashta. Pikërisht në një qytet të tillë zhvillohet historia e Momosë.

Jashtë, në cepin jugor të këtij qyteti të madh, atje ku fillojnë fushat e para dhe kasollet e shtëpitë duken gjithnjë e më

të varfra, të fshehura në një pyll të vogël pishash, ndodhen gërmadhat e një amfiteatri të vogël. Edhe në kohët e lashta nuk kishte qenë ndonjë amfiteatër madhështor, por kishte qenë, si të thuash, një teatër për njerëz më të varfër. Në ditët tona, domethënë në kohën kur filloi historia e Momosë, këto gërmadha ishin pothuajse fare të harruara. Për to kishin dijeni vetëm disa profesorë të antikitetit, por që tashmë nuk merreshin më me to, sepse nuk kishin ç'të zbulonin më atje. Ato nuk zgjonin ndonjë lloj interesi apo të mateshin me të tjerat që ekzistonin në qytetin e madh. Kështu, herë pas here, krejt pa dashje, përfundonin aty disa turistë, të cilët, tërë zhurmë, ngjiteshin në shkallaret e gurta të mbuluara nga bari, bënë ndonjë foto për kujtim dhe largoheshin përsëri. Pas kësaj, mbi rrethin e gurtë binte përsëri qetësia, kurse gjinkallat ia merrnin strofës tjetër të këngës së tyre pafund, e cila, meqë ra fjala, nuk kishte asnjë ndryshim nga ajo e mëparshmja.

Në të vërtetë ishin vetëm njerëzit aty përreth që kishin dijeni për këtë ndërtim të çuditshëm të rrumbullakët. Ata nxirrnin aty dhitë për kullotë, fëmijët e shfrytëzonin sheshin e rrumbullakët në mes për të luajtur me top, kurse mbrëmjeve, ndonjëherë aty takoheshin edhe çiftet e dashuruara.

Por, një ditë, u hap fjala se, kohëve të fundit, te gërmadhat po banonte dikush. Me sa dukej, ishte një fëmijë, një vajzë e vogël. Megjithatë askush nuk mund ta thoshte me saktësi, sepse vishej pak si çuditshëm. Thuhej se quhej Momo apo diçka e tillë.

Në të vërtetë, paraqitja e jashtme e Momosë ishte pak e veçantë dhe ndoshta i trembte pak njerëzit që i kushtonin rëndësi të madhe pastërtisë dhe rregullit.

Ajo ishte e shkurtër dhe aq e dobët sa, me gjithë dëshirën e mirë, nuk mund ta dalloje nëse ishte tetë apo dymbëdhjetë vjeçe. Kokën e kishte të mbuluar me kaçurrela si kaçube, pis të zeza, që dukeshin sikur s'kishin provuar kurrë ndonjë krehër apo gërshërë. Kishte sy të bukur shumë të mëdhenj, gjithashtu pis të zinj, si dhe këmbë në të njëjtën ngjyrë, sepse bariste pothuajse gjithnjë zbatshur. Vetëm në dimër vishte ndonjëherë këpucë, por dy të ndryshme që nuk përputheshin me njëra-tjetrën dhe përveç kësaj ishin shumë të mëdha për këmbën e saj. Kjo për arsye se Momoja nuk kishte asgjë të sajën, përveç atyre që gjente diku apo ia falnin. Fustani i saj ishte prej copa leckash ngjyra-ngjyra të qepura së bashku dhe i binte deri në fund të këmbëve. Sipër vishte një pallto të vjetër burrash, shumë të madhe për të, me mëngë të përveshura në kyçet e duarve. Nuk donte t'i shkurtonte sepse, me largpamësi, mendonte se do të rritej akoma. E ku i dihej nëse do të mund të gjente përsëri ndonjë pallto aq të bukur dhe praktike me aq shumë xhepa.

Poshtë skenës së mbuluar me bar të gërmadhave të teatrit ndodheshin disa dhoma gjysmë të shkatërruara, ku mund të hyje nga një vrimë në murin e jashtëm. Pikërisht aty Momoja kishte ngritur follenë e saj.

Një ditë, në drekë, erdhën disa burra e gra nga rrethinat fqinje aty afër dhe u përpoqën të nxirrnin ndonjë informacion prej saj. Momoja rrinte përballë tyre duke i parë gjithë frikë, ngaqë trembej se mos e zbonin prej andej. Po e kuptoi menjëherë se ata ishin njerëz të mirë. Edhe ata vetë ishin të varfër dhe e njihnin mirë jetën.

- Pra, kështu, - i tha njëri prej burrave, - ty të pëlqen këtu?

- Po, - iu përgjigj Momoja.

- Dhe ke ndërmend të rrish këtu?
- Po, kam qejf.
- Po mirë, nuk ka njeri që bëhet merak për ty?
- Jo.
- Desha të them, mos duhet të kthehesh përsëri në shtëpi?
- Kjo është shtëpia ime, - e siguroi Momoja sakaq.
- Po nga je ti, moj vajzë?

Momoja bëri një lëvizje të papërcaktuar dhe tregoi diku larg me dorë.

- Po cilët janë prindërit e tu? - deshi të dinte burri më tej.

E hutuar, fëmija pa atë dhe njerëzit e tjerë dhe ngriti pak supet. Njerëzit shkëmbyen shikime me njëri-tjetrin dhe psherëtinë.

- Mos ki frikë, - vazhdoi burri, - nuk kemi ndërmend të të zbojmë. Duam vetëm të të ndihmojmë.

Momoja pohoi me kokë, por jo krejtësisht e bindur.

- Thua që e ke emrin Momo, kështu?
- Po.
- Paske emër të bukur, po s'e kam dëgjuar ndonjëherë më parë. Kush ta ka vënë?
- Vetë, - tha Momoja
- Ti ia ke vënë vetes këtë emër?
- Po.
- Kur ke lindur?

Momoja u mendua pak dhe më në fund tha:

- Me sa mbaj mend unë, këtu kam qenë gjithmonë.
- Po nuk ke ndonjë teze, hallë, xhaxha, gjyshe a familje ku mund të shkosh?

Momoja ia nguli sytë burrit dhe një copë herë nuk nxori zë.

Pastaj murmuriti:

- Kjo është shtëpia ime.

- Mirë, mirë, - ia bëri burri, - po ti je fëmijë. Po sa vjeçe je në të vërtetë?

- Njëqind, - tha Momoja me ngurrim.

Njerëzit qeshën, ngaqë kujtuan se po bënte shaka.

- Hë, pra, e kam me gjithë mend, sa vjeçe je?

- Njëqind e dy, - u përgjigje Momoja, ende pak e pasigurt.

U desh një copë herë deri sa njerëzit ta kuptonin se fëmija dinte të thoshte vetëm disa numra që i kishte kapur aty-këtu, por që nuk e dinte çfarë donin të thoshin, sepse nuk e kishte mësuar njeri të numëronte.

- Shiko, - i tha burri, pasi ishte këshilluar me të tjerët, - do të të pëlqente sikur të lajmëronim policinë që ti je këtu? Në këtë rast do të të çonin në ndonjë strehë, ku do të kesh për të ngrënë dhe shtrat për të fjetur dhe ku do të mësosh të numërosh, të lexosh, të shkruash, si dhe shumë gjëra të tjera. Hë, si të duket kjo?

Momoja e pa e tmerruar.

- Jo, - mërmëriti, - nuk dua të shkoj atje. Kam qenë njëherë. Kishte edhe fëmijë të tjerë. Dritaret ishin me heku-
ra. Çdo ditë haje dru, po fare pa të drejtë. Një natë, kapër-
ceva murin dhe ia mbatha. Nuk dua të shkoj përsëri atje.

- E mora vesh, - ia bëri një burrë i vjetër duke pohuar me kokë. Edhe njerëzit e tjerë e kuptuan se si qëndronte puna dhe tundën kokën në shenjë pohimi.

- Mirë, atëherë, - ndërhyri një grua, - por ti je e vogël. Dikush duhet të kujdeset për ty.

- Unë, - ia ktheu Momoja e lehtësuar.

- E bën dot ti këtë? - e pyeti gruaja.

Momoja heshti një copë herë dhe pastaj tha me zë të ulët:

- Nuk kam nevojë për shumë gjëra.

Njerëzit shkëmbyen përsëri vështrime me njëri-tjetrin, psherëtinë dhe tundën kokat.

- E di, Momo, - e mori përsëri fjalën burri që kishte folur i pari, - ne mendojmë se ti mund ta fusësh kokën te ndonjëri nga ne. Megjithëse të gjithë nuk kemi aq shumë vend dhe shumica jonë kanë nga një tufë me fëmijë që duhen ushqyer, po themi se një më shumë e një më pak nuk prish ndonjë punë. Hë, si thua?


- Faleminderit, - tha Momoja duke buzëqeshur për herë të parë, - shumë faleminderit! Po a nuk mund të më lini të banoj këtu ku jam?

Njerëzit u këshilluan me njëri-tjetrin dhe më në fund ranë në një mendje. Se, në fund të fundit, aty fëmija do të ishte po aq mirë sa dhe te ndonjëri prej tyre dhe të gjithë së bashku do të kujdeseshin për Momonë e se, gjithsesi, për të gjithë bashkë do të ishte më e lehtë se vetëm për njërin prej tyre.

Me aq sa mundën, iu futën menjëherë punës duke pastruar dhe rregulluar dhomën e gurtë të rrëzuar ku banonte Momoja. Njëri prej tyre, që ishte murator, i ndërtoi madje një sobë të vogël prej guri. Gjetën edhe një tub të ndryshkur sobe. Një marangoz i vjetër i bëri një tryezë të vogël dhe dy stola me dërrasat e ca arkave. Në fund, gratë i sollën edhe një shtrat të vjetër hekuri të zbukuruar me lajle e lule, një dyshek që nuk ishte grisur shumë, si dhe dy mbulesa. Guva poshtë skenës së gërmadhëve ishte shndërruar ndërkaq në një dhomëz të vogël të këndshme. Muratori, që i vinte ndoresh edhe për art, në fund i pikturoi në mur një tablo të bukur me lule. Madje ia pikturoi edhe kornizën dhe gozhdën ku varej tabloja. Pastaj erdhën fëmijët e atyre njerëzve dhe sollën me vete ushqimet që u kishin mbetur: kush një copë djathë, kush ndonjë simite të

vogël, një i tretë ca fruta e kështu me radhë. Dhe meqenëse kishte aq shumë fëmijë, atë mbrëmje u mbledh një turmë e tillë sa të gjithë festuan me njëri-tjetrin në amfiteatër një festë të vogël të vërtetë për nder të hyrjes së Momosë në shtëpinë e re. Ishte një festë tejet e gëzueshme, ashtu siç dinë të festojnë vetëm njerëzit e varfër.

E kështu filloi miqësia midis Momosë dhe njerëzve nga rrethinat fqinje aty pranë.



KAPITULLI I DYTË

Një veti e pazakontë dhe një zënkë fare e zakonë

Që nga ai çast, Momoja e vogël filloi të jetonte mirë, gjithsesi sipas mendimit të saj. Tani kishte gjithmonë ndonjë gjë për të ngrënë, herë më shumë dhe herë më pak, si të ndodhte dhe sipas mundësive të njerëzve për t'i dhënë diçka. Kishte një çati mbi kokë e një shtrat dhe, kur bënte ftohtë, mund të ndizte edhe ndonjë zjarr. Po më e rëndësishmja ishte se tani kishte shumë miq të mirë.

Pra, mund të thuhej se Momoja kishte qenë vërtet me fat që kishte takuar njerëz aq të mirë. Ajo vetë ishte e bindur plotësisht për këtë. Por edhe vetë njerëzit e kuptuan shpejt se edhe ata nuk kishin qenë me më pak fat. Atyre u duhej Momoja dhe habiteshin se si kishin bërë më parë pa të. Dhe sa më shumë rrinte me ta, aq më e domosdoshme iu bëhej, aq e domosdoshme sa trembeshin se mos, ndonjë ditë të bukur, ajo zhdukej përsëri.

Kjo ishte arsyeja pse shkonin shumë njerëz për ta takuar Momonë. Pothuajse gjithnjë të zinte syri dikë të ulur pranë saj e duke biseduar me zell. Kurse ata që ia kishin nevojën, por nuk shkonin dot vetë, dërgonin dikë që ta thërriste. Ndërsa atyre që nuk e kishin kuptuar ende se iu nevojitej, të tjerët u thoshin: "Po shko te Momoja!"

Pak nga pak, kjo fjali u bë një shprehje fikse për njerëzit e rrethinave fqinje aty afër. Njëlloj siç thuhet "gjithë të mirat!" apo "të bëftë mirë!" a "një Zot e di!", thuhej edhe në të gjitha rastet e mundshme: "Po shko te Momoja!"

Po pse? Mos vallë Momoja ishte aq e zgjuar sa mund t'i jepte çdokujt këshilla të mira? Apo gjente gjithnjë fjalët e duhura për çdo njeri që kishte nevojë për ngushëllim? Apo ishte e zonja të jepte gjykime të urta dhe të drejta?

Jo, Momoja, si çdo fëmijë tjetër, s'i bënte dot këto gjëra.

Atëherë, mos kishte gjë vallë aftësinë për t'i sjellë njerëzit në qejf? Kështu për shembull, a dinte Momoja të këndon-te bukur? Apo dinte të luante në ndonjë vegël muzikore? Ose, në fund të fundit, meqenëse jetonte në një lloj cirku, mos dinte gjë të kërcente apo të bënte numra akrobatikë?

Jo, as këto veti nuk i kishte.

Mos vallë dinte të bënte magji? Mos dinte ndonjë fjalë magjike që mund të t'i hiqte të gjitha hallet dhe problemet? Mos dinte të hidhte fall apo të parashikonte të ardhmen?

Asnjërën prej këtyre.

Ajo që Momoja e vogël dinte ta bënte si askush tjetër ishte të të dëgjonte me vëmendje. Ndoshta disa lexues do të thoshin se, të dëgjosh, nuk është ndonjë gjë e veçantë, këtë mund ta bëjë gjithkush.

E keni gabim. Vetëm pak njerëz dinë të të dëgjojnë vërtet. Dhe mënyra se si të dëgjonte Momoja ishte e papërsëritshme.

Momoja të dëgjonte në mënyrë të atillë sa, papritur, edhe njerëzve të trashë u vinin mendime të zgjuara. Jo se u thoshte apo i pyeste për ndonjë gjë që ta bënte tjetrin t'i vinin në kokë mendime të tilla, jo, ajo vetëm sa i dëgjonte me vëmendje dhe simpati të madhe duke i parë me sytë e saj të mëdhenj e të zinj, kurse ata ndienin t'u vinin menjëherë në kokë mendime që nuk iu kishte shkuar në mendje ndonjëherë se i kishin aty.

Ajo kishte aftësinë t'i dëgjonte të tjerët në një mënyrë të atillë sa edhe njerëzit më të pavendosur dhe që s'dinin

nga t'ia mbanin, e kuptonin menjëherë se çfarë donin. Ose, edhe më të ndrojturit, papritur e ndienin veten të lirë dhe të guximshëm. Ose edhe njerëzit më të palumtur dhe në depresion bëheshin të hareshëm dhe të sigurt në vetvete. Dhe nëse ndonjëri mendonte se jeta e tij ishte kot dhe pa kuptim dhe se ai ishte një ndër miliona, një njeri i parëndësishëm, që mund të zëvendësohej po aq kollaj siç zëvendësohen kusitë e prishura - dhe shkonte e ia tregonte të gjitha këto Momosë së vogël, në një mënyrë krejt misterioze, edhe pa mbaruar ende së foluri - e kuptonte se e kishte krejtësisht gabim, se ai, pikërisht ashtu siç ishte, ishte i papërsëritshëm ndër të gjithë njerëzit e tjerë dhe prandaj, në mënyrën e tij të veçantë, ishte i rëndësishëm për botën.

Ja, kjo ishte aftësia e Momosë për të dëgjuar të tjerët!

Një ditë, në amfiteatër, shkuan tek ajo dy burra që ishin zënë për vdekje dhe nuk donin më të flisnin me njëri-tjetrin, megjithëse ishin fqinjë. Të tjerët i kishin këshilluar të takonin një herë Momonë, se nuk shkonte që fqinjët të jetonin në armiqësi. Në fillim të dy burrat nuk kishin pranuar, po më në fund ishin dorëzuar pa qejf.

Ndërkohë ata kishin zënë vend në amfiteatër, të heshtur dhe inatçorë, secili në anën tjetër të radhëve të gurta, me vështrime të ngrysur.

Njëri prej tyre ishte muratori që kishte bërë sobën dhe pikturën e bukur me lule në "dhomën e ndenjjes" të Momosë. Ai quhej Nikollë dhe ishte një burrë i fuqishëm me mustaqe të zeza të spërdredhura. Kurse tjetri e kishte emrin Nino. Ai ishte i dobët dhe gjithnjë dukej pak si i lodhur. Ninoja kishte marrë me qira një lokal të vogël në rrethinat e qytetit, ku zakonisht shkonin vetëm disa pleq që, gjatë gjithë mbrëmjes, merrnin vetëm një gotë verë dhe

flisnin për kujtimet e tyre. Edhe Ninoja dhe gruaja e tij e shëndoshë bënë pjesë në rrethin e miqve të Momosë dhe i sillnin shpesh ndonjë gjë për të ngrënë.

Momoja e vuri re që të dy ishin të inatosur me njëri-tjetrin dhe nuk dinte se te cili të shkonte në fillim. Më në fund, që të mos lëndonte asnjërin prej tyre, zuri vend njësoj larg prej të dyve, buzë skenës së gurtë, duke parë herë njërin dhe herë tjetrin dhe duke pritur se çfarë do të ndodhte ndërkaq. Disa gjëra duan kohën e tyre - dhe koha ishte gjëja e vetme që Momoja e kishte me shumicë.

Kishte një copë herë që të dy burrat rrinin ashtu ulur kur, papritur, Nikolla brofi më këmbë dhe tha:

- Unë po iki. Duke ardhur këtu, tregova vullnetin tim të mirë. Dhe ti, Momo, e sheh edhe vetë sa kokëfortë është ai. Pse duhet të pres më shumë unë?

Dhe me të vërtetë bëri të largohej.

- Ik ti, ik! - i thirri Ninoja nga mbrapa. - Kot që erdhe. Nuk kam ndërmend të pajtohem me një kriminel!

Nikolla kërceu përpjetë me fytyrën flakë të kuqe nga zemërimi.

- Kush është kriminel? - thirri ai me kërcënim dhe u kthye përsëri. - Hë, thuaje edhe një herë!

- Sa herë të duash ti! - ulëriti Ninoja. - Kujton se, ngaqë je i fortë dhe brutal, nuk guxon njeri të ta thotë të vërtetën në fytyrë? Po ja ku po të ta them unë ty dhe të gjithë atyre që duan ta dëgjojnë! Hë, pra, eja dhe më vrit, siç deshe ta bëje njëherë!

- Ah, kur s'e bëra! - ulëriti me të madhe Nikolla duke shtrenguar grushtet. - Momo, e sheh si gënjen dhe shpif? Vetëm një herë e kapa nga jaka dhe e vërvita në pellgacën e ujërave të larjes së enëve prapa mejhanes së tij. Po aty as

miu i gjirizeve nuk mbytet! - Dhe duke iu kthyer përsëri Ninos, bërtiti: - Por, fatkeqësisht, siç duket, je ende gjallë!

Një copë herë shkëmbyen sharje nga më të çmendurat, ndërsa Momoja nuk po e merrte vesh fare për se bëhej fjalë dhe pse po ziheshin aq keq. Po dalëngadalë doli se Nikolla e kishte nëpërkëmbur Ninon vetëm e vetëm se ai, në sy të disa klientëve, i kishte dhënë një pëllëmbë. Kjo kishte ndodhur për arsye se, më parë, Nikolla ishte munduar të thyente të gjitha enët e Ninos.

- S'është aspak e vërtetë! - mbrohej Nikolla me të madhe.
- Vetëm një krikëll përplasa pas murit dhe ajo gjithsesi e krisur ishte!

- Po ishte kriklla ime, merr vesh ti? - i përgjigjej Ninoja.
- Dhe ti s'ke asnjë të drejtë ta bësh këtë!

Nikolla ishte plotësisht i bindur se kishte vepruar drejt, sepse Ninoja e kishte lënduar në nderin e muratorit.

- A e di ç'ka thënë ai për mua? - i tha ai Momosë duke thirrur. - Ka thënë se unë s'e bëkam dot një mur të drejtë, se qenkam tapë ditë e natë. Se edhe stërgjyshi im paska qenë po kështu dhe se ai paska marrë pjesë në ndërtimin e Kullës së shtrembër të Pizës!

- Nikollë, - iu përgjigj Ninoja, - po ishte vetëm një shaka!

- Shaka e bukur! - gjëmoi Nikolla. - Nuk më bën fare për të qeshur.

Megjithatë, doli se Ninoja i ishte përgjigjur kështu vetëm një shakaje tjetër që kishte bërë Nikolla. Një mëngjes, në derën e Ninos ishte shkruar me germa flakë të kuqe pikërisht kështu: "Ai që s'bëhet dot gjë, bëhet hanxhi". Po edhe Ninos kjo nuk i dukej për të qeshur.

Duke folur përsëri gjithë zemërim, ata u zunë një copë herë se kush nga të dyja shakatë kishte qenë më e mira. Por befas pushuan.

Momoja i pa me habi, po asnjëri prej tyre nuk arrinte ta kuptonte mirë shikimin e saj. Mos po tallej me ta? Apo ishte e pikëlluar? Nga fytyra nuk merrej vesh gjë. Por, befas, të dy burrave iu duk sikur po shihnin veten në pasqyrë dhe filloi t'u vinte turp.

- Mirë, - ia bëri Nikolla, - ndoshta nuk duhej ta kisha shkruar atë në derën tënde, Nino. Nuk do ta kisha bërë sikur ti të mos kishe refuzuar të më hidhje një gotë verë. Ishte e kundërligjshme, e kupton? Sepse unë paguaj gjithnjë dhe nuk kishe arsye të më trajtoje ashtu.

- Kisha, si nuk kisha! - ia ktheu Ninoja. - Nuk e mban mend më atë historinë me Antonin e shenjtë? Ah, tani po zverdhesh! Ma hodhe paq atëherë, po unë nuk e duroj dot këtë.

- Unë ty? - bërtiti Nikolla duke gulçuar me tërbim nga inati. - Përkundrazi! Ti doje të ma hidhje mua, vetëm se nuk ia dole dot!

Historia ishte kjo... Në lokalin e vogël të Ninos varej në mur një pamje që paraqiste Antonin e shenjtë. Ishte një fotografi me ngjyra, që Ninoja e kishte prerë dikur nga një gazetë e ilustruar dhe e kishte vënë në kornizë.

Një ditë, Nikolla donte të bënte pazar me Ninon për t'ia blerë këtë fotografi - se gjoja i dukej shumë e bukur. Ndërsa Ninoja, si një matrapaz i shkathët, më në fund ia kishte mbushur mendjen Nikollës që t'i jepte radion e tij në shkëmbim të fotografisë. Ninoja kishte qeshur me ligësi me vete se, sigurisht, Nikolla kishte dalë goxha keq nga kjo punë. Shkëmbimi u krye.

Po pastaj doli se midis fotografisë dhe kartonit mbajtës së saj ndodhej një kartëmonedhë për të cilën Ninoja nuk kishte ditur gjë. Tani ishte ai që kishte dalë me humbje dhe i vinte inat. Shkurt, i kërkoi Nikollës t'ia kthente paratë, sepse ato nuk kishin qenë pjesë e shkëmbimit. Nikolla re-

fuzoi t'ia kthente, ndaj Ninoja nuk donte t'i jepte më për të pirë. Kështu kishte filluar grindja.

Si ia nxorën kokën historisë, të dy heshtën një copë herë.

Pastaj Ninoja pyeti:

- Nikollë, më thuaj një herë tani krejt sinqerisht: e dije apo nuk e dije për paratë para se të bënim shkëmbimin?

- Sigurisht, përndryshe nuk do ta kisha bërë shkëmbimin.

- Atëherë duhet të pranosh se më ke mashtruar!

- Pse? Ti vërtet nuk dije gjë për paratë?

- Jo, për nder!

- E po, më në fund. Domethënë doje të ma hidhje, ndryshe si doje të ma merrje radion për një copë gazete pa vlerë, ë?

- Po ti, nga e dije për paratë?

- Dy net më parë, pashë se si një klient i futi paratë atje si blatë për Antonin e shenjtë.

Ninoja kafshoi buzët.

- Ishin shumë?

- As më pak dhe as më shumë se vlera e radios sime, - ia ktheu Nikolla.

- Atëherë, - tha Ninoja i zhytur në mendime, - në të vërtetë, e gjithë grindja jonë bëhet vetëm për Antonin e shenjtë, që e kisha prerë nga gazeta.

Nikolla kroi kokën.

- Në fakt, po, - hungëriti ai, - mund ta marrësh prapë, Nino.

- Punë që s'bëhet! - ia ktheu Ninoja me dinjitet. - Ajo që është shkëmbyer, është shkëmbyer! Burrat me namuz i japin dorën njëri-tjetrit!


Dhe befasi të dy filluan të qeshnin njëkohësisht. Zbritën poshtë duke u hedhur nëpër radhët e gurta, u takuan në mes të sheshit të rrumbullakët të mbuluar nga bari dhe

u përçafuan duke i rënë njëri-tjetrit në shpatulla. Pastaj morën Momonë hopa dhe i thanë:

- Shumë faleminderit!

Pas një copë here, kur ata po largoheshin, Momoja ua bëri gjatë me dorë. Ishte shumë e kënaqur që dy miqtë e saj po shkonin përsëri mirë me njëri-tjetrin.

Njëherë tjetër, një djalë i vogël i solli kanarinën e tij, që nuk donte të këndonte. Kjo ishte një detyrë shumë më e vështirë për Momonë. Asaj iu desh ta dëgjonte zogun një javë të tërë, derisa ai më në fund filloi përsëri ta përdridhte zërin dhe të cicëronte.



Momoja i dëgjonte të gjithë, qentë dhe macet, bulkthat dhe zhabat, madje edhe shiun e erën nëpër pemë. Dhe gjithkush i fliste sipas mënyrës së vet.

Disa herë, mbrëmjeve, kur të gjithë miqtë e saj ishin kthyer në shtëpitë e tyre, ajo vazhdonte të rrinte vetëm,

ulur në rrethin e madh të gurtë të teatrit të vjetër, nën kubënë e qiellit të ndriçuar nga drita e yjeve, ku i vinte veshin heshtjes së madhe.

Atëherë asaj i dukej sikur ishte ulur në mes të ndonjë veshi të madh që dëgjonte më vëmendje botën e yjeve. Dhe i dukej sikur dëgjonte ndonjë muzikë të lehtë, por të fuqishme, që çuditërisht e mallëngjente shumë.

Gjatë netëve të tilla ajo shihte gjithnjë ëndrra shumë të bukura.

Dhe kush mendon se të dëgjosh nuk është ndonjë gjë e veçantë, le ta provojë një herë vetë nëse është i zoti ta bëjë këtë po kaq mirë.